



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seancë plenare e Kuvendit

P- 032

Prishtinë, më 29 korrik 2008, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala e seancave plenare.

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 29 KORRIK 2008**

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmuan **Nexhat Daci dhe Ibrahim Gashi**, anëtarë të Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 89 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite:

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 15 korrik 2008,
2. Koha për pyetjet parlamentare,
3. Shqyrtimi parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L08 për miratimin e Buxhetit të Kosovës dhe shpenzimet e autorizuara për periudhën prej 1 janar deri më 31 dhjetor 2008,
4. Shqyrtimi parë i Projektligjit për partneritetet publiko-privat dhe koncesionet për

- sigurimin e infrastrukturës së shërbimeve publike dhe procedurat për dhënien e tyre,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për vula në institucionet e Republikës së Kosovës,
 6. Shqyrtimi i Rekomandimit të Organit të pavarur përzgjedhës për emërimin e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit,
 7. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2007,
 8. Shqyrtimi i kërkesës së Qeverisë së Kosovës për tërheqjen e ligjeve nga procedura e shpalljes, dhe
 9. Shqyrtimi i kërkesës së grupeve parlamentare të Kuvendit për procedimin e ligjeve të pashpallura në rishqyrtim në komisionet parlamentare.

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 15 korrik 2008

Procesverbali i seancës plenare të mbajtur më 15 korrik 2008, u miratua pa vërejtje.

2. Koha për pyetjet parlamentare

Deputetja **Mufera Şinik** i parashtroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë **Enver Hoxhaj** lidhur me botimin e mjeteve mësimore në gjuhën turke për arsimin e mesëm.

Ministri **Enver Hoxhaj** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Şinik**.

Deputetja **Rita Hajzeraj** i parashtroi pyetje ministrit të Punëve të Brendshme **Zenun Pajaziti** lidhur me hyrjen e trupave të armatosura të Malit të Zi brenda territorit të Kosovës.

Kryeministri **Hashim Thaçi** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Hajzeraj**.

Deputeti **Ibrahim Makolli** i parashtroi pyetje ministrit të Punëve të Brendshme **Zenun Pajaziti** lidhur me skadimin e afatit të vlefshmërisë së patentë shoferëve

Ministri **Zenun Pajaziti** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Makolli**.

Deputetet **Fatmire Berisha** dhe **Gjylnaze Syla** parashtruan pyetje të njëjtë për ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor **Mahir Yagcilar** lidhur me vendosjen e tri maunave me vaj disulfurik në parkun industrial “Trepça” në Mitrovicë.

Ministri **Mahir Yagcilar** iu përgjigj pyetjes së deputeteve **Berisha** dhe **Syla**.

Deputetja **Donika Kadaj-Bujupi** i parashtroi pyetje Kryeministrit **Hashim Thaçi** lidhur me masat e ndërmarra të Qeverisë për luftimin e korrupsionit.

Kryeministri **Hashim Thaçi** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Kadaj-Bujupi**.

Deputetja **Rita Hajzeraj** i parashtroi pyetje Kryeministrit **Hashim Thaçi** lidhur me vazhdimin e mandateve të kryetarëve të komunave në vendbanimet me shumicë serbe.

Kryeministri **Hashim Thaçi** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Hajzeraj**.

Deputetja **Gjylnaze Syla** i parashtroi pyetje Kryeministrit **Hashim Thaçi** lidhur me themelimin e Agjencisë Kosovare për Inteligjencë dhe të Ministrisë së Forcës së Sigurisë.

Kryeministri **Hashim Thaçi** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Syla**.

Deputetja **Sanije Aliaj** i parashtroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë **Enver Hoxhaj** lidhur me zgjerimin e kapaciteteve për përfshirjen e fëmijëve në objektet parashkollore.

Ministri **Enver Hoxhaj** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Aliaj**.

Deputetja **Sanije Aliaj** i parashtroi pyetje Kryeministrit **Hashim Thaçi** lidhur me zbatimin e Ligjit për barazi gjinore dhe krijimin e kushteve të barabarta për femra në fushën e punësimit.

Kryeministri **Hashim Thaçi** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Aliaj**.

Deputetja **Sanije Aliaj** i parashtroi pyetje ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor **Mahir Yagcilar** lidhur me masat e ndërmarra për mënjanimin e deponimeve të automjeteve të prishura përkaj magjistrales Prishtinë - Ferizaj.

Ministri **Mahir Yagcilar** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Aliaj**.

Deputetja **Gjylnaze Syla** i parashtroi pyetje zëvendëskryeministrit **Hajredin Kuçi** lidhur me përmbushjen e kërkesave të ish-punëtorëve të RTP-së.

Zëvendëskryeministri **Hajredin Kuçi** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Syla**.

3. Shqyrtimi parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L08 për miratimin e Buxhetit të Kosovës dhe shpenzimet e autorizuara për periudhën prej 1 janar deri më 31 dhjetor 2008

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta paraqesë Projektligjin para deputetëve të Kuvendit.

Kryeministri i Kosovës, **Hashim Thaçi**, tha se Kosova ndodhet në një periudhë shumë të rëndësishme të zhvillimit të saj ekonomik. Një numër i madh i vendeve të fuqishme e ka njohur pavarësinë e shtetit tonë, dhe një numër i vendeve të tjera janë në proces të njohjes. Në të njëjtën kohë, është aplikuar për anëtarësimin e vendit në institucionet financiare ndërkombëtare, siç janë: Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore. Presim përgjigje sipas procedurës që kanë këto institucione.

Kohë më parë është mbajtur edhe Konferenca e Donatorëve për Kosovën, në të cilën Konferencë një ndihmë të jashtëzakonshme financiare prej 1.2 miliardë eurosh është zotuar për vitet e ardhshme për Kosovën.

Kjo edhe njëherë tregon se partnerët tanë ndërkombëtarë janë shumë të zotuar që të ndihmojnë Kosovën në zhvillimin ekonomik dhe në ecjen e saj drejt integritit në Bashkimin Evropian dhe në NATO.

Një fushë tjetër në të cilën Qeveria ka qenë shumë e fokusuar, është ajo e rishikimit të buxhetit për vitin 2008. Buxheti i vitit 2008 ishte përgatitur në një periudhë shumë të shkurtër. Kjo ishte bërë për arsye të mosvonesave në fillimin e ekzekutimit të buxhetit, e në veçanti të ekzekutimit të shpenzimeve kapitale.

Që nga periudha e aprovimit të buxhetit për vitin 2008 e deri më tani, kur edhe e kemi bërë rishikimin e buxhetit, kemi trende pozitive. Përderisa ekzekutimi i shpenzimeve kapitale ka shënuar një rritje krahasuar me vitin e kaluar, në të njëjtën kohë kemi parë një rritje të të hyrave në raport me ato të planifikuara.

Ministri i Ekonomisë dhe i Financave, **Ahmet Shala**, tha se Ligji mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë e vitit 2008 mundëson bërjen e modifikimeve në buxhetet e aprovuara më parë.

Në bazë të këtij ligji Ministria për Ekonomi dhe Financa, më 30 qershor 2008, ka kërkuar nga të gjitha organizatat buxhetore të ofrojnë rekomandime për ndryshime në këtë ligj, për miratimin e Buxhetit të Kosovës. Kërkesa nga organizatat buxhetore, nga ministritë, komunat dhe institucionet e tjera, kanë qenë rreth 147.300.000 euro.

Për t'i adresuar kërkesat për financim gjatë vitit 2008, Qeveria ka aprovuar shumën prej 111.700.000 euro.

Rritjet më të mëdha janë, si vijon: 1.200.000 euro për Ministrinë e Punëve të Jashtme, me qëllim të mbulimit të nevojave për funksionimin e ambasadave dhe të përfaqësive diplomatike; 3,4 milionë për Ministrinë e Punëve të Brendshme, kryesisht për mbulimin e dokumenteve të reja identifikuese të Republikës së Kosovës, që i zëvendësojnë dokumentet e UNMIK-ut dhe shërbimet e tjera konform ligjit; 2.000.000 euro për licencimin e arsimtarëve; 7,8 milionë euro për Ministrinë e Shëndetësisë, prej tyre 3,8 milionë euro për barërat esenciale, 2.000.000 euro për trajtim mjekësor jashtë vendit, 2.000.000 euro për borxhet e mbetura nga vitet e kaluara.

Pastaj, 42.000.000 euro për nevojat e zhvillimit të KEK-ut dhe nevojat e importimit të rrymës gjatë periudhës së vjeshtës, prej tyre 25.000.000 euro për import të energjisë dhe 17.000.000 për kontingjentin në Minierën e Sibovcit.

35.000.000 euro janë në Ministrinë e Transportit dhe Post -Telekomunikacionit, kryesisht këto mjete do të jenë në funksion të zhvillimit ekonomik, pasi do të adresojnë ndërtimin e rrugëve të reja, rehabilitimin e rrugëve magjistrale, mirëmbajtjen e rrugëve ekzistuese dhe bashkëfinancimin e projekteve të përbashkëta me kuvendet komunale.

Rishikimi për gjashtëmujorin e parë nuk bën ndryshime përmbajtësore në shumat për shpenzimet operative, për paga e mëditje, mallra e shërbime, shërbime komunale, kurse te subvencionet e transferet dhe shpenzimet kapitale ndryshojnë ndjeshëm: shpenzimet operative kryesisht mbulojnë vetëm nevojat imediate për sektorin e shëndetësisë, përgjegjësitë e reja ose bartjet e përgjegjësive nga UNMIK-u në Qeverinë e Republikës së Kosovës, ngritjet e çmimeve të tregut për sektorin e drejtësisë, sidomos në furnizim.

Te shpenzimet kapitale janë rritur 18,7 milion euro. Kjo rritje do të ndikojë në zgjerimin e bazës materiale për të gjithë qytetarët tanë.

Në fund, ju ftoj të apromoni rishikimin gjashtëmujor të buxhetit për këtë vit.

Kryetari hapi debatin për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L08 për miratimin e Buxhetit të Kosovës dhe shpenzimet e autorizuar për periudhën prej 1 janar deri më 31 dhjetor 2008.

Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, **Gani Koci**, tha se Komisioni e ka shqyrtuar propozimin e Qeverisë për rishikim të Buxhetit. Në parim, ne kemi kërkuar që ky Ligj të shqyrtohet në Kuvend, duke pasur parasysh se në leximin e dytë disa vërejtje parimore që i ka bërë Komisioni, në formën e amendamentuar, do t'i përfshijmë dhe ato do të sillen në leximin e dytë të këtij Projektligji.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Ramë Buja**, tha se me shumë kujdes e kanë shqyrtuar rishikimin e buxhetit të vendit për këtë vit, të cilin e mbështet në leximin e parë.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së **Lutfi Haziri**, tha se mbështet në lexim të parë rishqyrtimin buxhetor, në kufijtë e paraqitur. Natyrisht, Grupi Parlamentar i LDK-së do t'i paraqet vërejtjet parimore që kanë të bëjnë me kufijtë buxhetorë, që kanë të bëjë me balancin e prioritetëve që ka paraqitur Qeveria, të politikave eks-sektoriale, të kapaciteteve, të ndërtimit të kapaciteteve harxhuese të Qeverisë në mënyrë që mjetet e planifikuara buxhetore dhe mjetet e donatorëve si pjesë e politikave, në këtë pjesë të dytë të vitit dhe në vitet tjera të jenë në përputhje me prioritetet dhe me politikat sektoriale që Qeveria i ka paraqitur.

Në emër të Grupit parlamentar të AKR-së, **Shkumbin Demaliaj**, tha se pas një analize që i kemi bërë këtij materiali mjaft voluminoz për një kohë relativisht të shkurtër, kemi arritur që t'i hartojmë vërejtjet tona dhe ato vërejtje i sublimojmë në dy pjesë, në vërejtjet parimore dhe në vërejtjet konkrete.

Në kudër të vërejtjeve parimore lidhur me Buxhetin e Kosovës, ne do të veçonim me sa vijon: ekziston një mosbalancim i të hyrave dhe të dalave të mjeteve buxhetore, që paraqet njërin ndër parimet kryesore të buxhetit. Në dokumentin buxhetor saktësisht duhet të përputhen të hyrat dhe të dalat, përkatësisht shpenzimet.

Në vazhdim, deputeti Demaliaj vërejtjet në lidhje me rishikimin e buxhetit i paraqiti përmes shifrave krahasuese, që janë dhënë në transkript.

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, tha se Projektbuxheti, të cilin e ka paraqitur Qeveria e Kosovës sot para nesh, realisht reflekton me konceptin qeverisës të deritanishëm të cilin e kemi parë, me konfuzitet, me gjërat të cilat janë kamufluar dhe janë fshehur.

Në vazhdim deputeti Gjini deklaroi se Grupit Parlamentar të AAK-së nuk e mbështet propozimin e Qeverisë për rishikim e buxhetit për vitin 2008 dhe i paraqiti vërejtjet e këtij grupi, të cilat janë dhënë në transkript.

Në emër të Grupi Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli**, tha se kanë analizuar me shumë vëmendje Projektligjin për rishikimin e buxhetit për vitin 2008 dhe me shumë keqardhje kanë konstatuar se ky planifikim i buxhetit më së mirë i reflekton dhe i vërteton shqetësimet tona të mëhershme se kjo qeveri e ka të vështirë të qeverisë vendin në kushte normale.

Kjo qeveri, me këtë qasje që po demonstroi, nuk është qeveri e progresit të Kosovës dhe nuk është qeveri e cila krijon stabilitet politik, social, e mos të flasim për atë ekonomik.

Në emër të Grupi Parlamentar "7+" **Sadik Idriz**, tha se si partner qeverisë e mbështet propozimin e qeverisë për rishikimin e buxhetit për këtë vit.

Ai pati vërejtje për disa projekte të realizuara nga Ministri për Komunitete dhe Kthim, të cilat, sipas tij, paraqesin konflikt interesi.

Në emër të Grupi Parlamentar të SLS, **Bojan Stojanoviq**, tha se mbështet propozimin e Qeverisë për rishikimin e buxhetit për këtë vit. Ai kërkoi që Qveria, për vitin e ardhshëm ta rrisë buxhetin për Ministrinë për Komunitete dhe Kthim në mënyrë që të realizohen projektet investuese në mjediset ku jetojnë komunitetet.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L08 për Buxhetin e Kosovës dhanë edhe këta deputetë: **Donika Kadaj, Gjylnaze Sylja, Rasim Selmanaj, Driton Tali, Sabri Hamiti, Haki Shatri, Ibrahim Gashi, Myzejene Selmani, Gani Koci, Zylfije Hundozi, Adem Salihaj, Gani Buçinca, Mark Krasniqi, Riza Smaka, Numan Baliq, Besa Gaxheri, Esat Brajshori, Dragisha Miriq, Zafir Berisha, Eset Cakolli, Edita Tahiri, Memli Krasniqi, Bahri Hyseni, Njomza Emini, Ardian Gjini, Vlora Çitaku, Synavere Rysha, Nait Hasani, Ibrahim Makolli, Qamile Morina, Ramadan Avdiu, Bajram Kosumi, Hajredin Kuçi, Hydajet Hyseni, Gani Geci, Safete Hadërgjonaj, Myrvete Pantina, Armend Zemaj dhe Adem Grabovci**, që janë dhënë në transkript të kësaj seance.

Në fund të debatit, ministri i Ekonomisë dhe i Financave, **Ahmet Shala**, iu përgjigj vërejtjeve dhe pyetjeve të deputetëve dhe i falënderoi ata për kontributin e dhënë gjatë këtij debati.

Pastaj, **Kryetari** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----58,
Kundër-----23,
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L08 për Buxhetin e Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa – si komision funksional dhe raportues, që ta shqyrtojë këtë projektligj dhe Kuvendit t’ia paraqesë Raportin me rekomandime për miratim në seancën e radhës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën e sotme në orën 18:20 minuta.

E mërkurë, 30 gusht 2008

Vazhdim i seancës

Në mbledhje ishin të pranishëm 68 deputetë.

Në fillim, seancën e kryesoi **Ibrahim Gashi**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

4. Shqyrtimi parë i Projektligjit për partneritetet publiko-privat dhe koncesionet për sigurimin e infrastrukturës së shërbimeve publike dhe procedurat për dhënien e tyre

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta paraqesë Projektligjin para deputetëve të Kuvendit.

Ministri i Ekonomisë dhe i Financave, **Ahmet Shala**, tha se Kosova, shtet i pavarur, ka nevojë urgjente për investime substanciale në infrastrukturën e saj publike dhe shërbimet në të gjithë sektorët.

Qeveria e Kosovës ka resurse financiare të kufizuara, andaj duhet të veprojë me një maturi fiskale për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Vetëm me ndihmën e investimeve dhe ekspertizën menaxheriale private Kosova mund t'i plotësojë nevojat e veta për infrastrukturë dhe shërbime cilësore.

Partneriteti publiko-privat siguron mundësi dhe hap ose shton nivelin e investimeve, pa i ngarkuar financat publike të Kosovës, përkatësisht pa i ngarkuar taksapaguesit e Kosovës.

Në këtë kontest, ligji i propozuar për partneritet publiko-privat ka për qëllim krijimin e kornizës për partneritetin publiko-privat dhe të koncesioneve në gjithë sektorët e ekonomisë, në: transport, shëndetësi, arsim, energji, punë komunale, shërbime publike etj.- përkatësisht aty ku ka nevojë për investime kapitale të mëdha.

Për sa i takon përmbajtjes, ky projektligj është në harmoni me sistemin juridik dhe kushtetues të Kosovës dhe është në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare.

Ligji i partneritetet publiko-privat do t'i mundësojë Kosovës të garojë me vendet e tjera rajonale për investimet private, si dhe do t'ia hapë derën për zhvillimin e saj të qëndrueshëm ekonomik.

Me partneritetin publiko-privat ne mund të ndërtojmë infrastrukturën dhe bazën tonë ekonomike, andaj ju lus që ta miratoni këtë projektligj.

Pas prezantimit të këtij projektligji nga ana e ministrit **Shala**, Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e tij, në parim.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Ramë Buja**, tha se do ta mbështesim në lexim të parë, duke insistuar që në leximin e dytë t'i bëjnë disa plotësime që janë të domosdoshme.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së **Sabri Hamiti**, tha se e përkrah në parim ligjin e paraqitur dhe shpresojmë që në diskutimet dhe në procedurat e mëtejshme do të marrë formën më të përshtatshme deri në aprovimin përfundimtar.

Në emër të Grupit parlamentar të AKR-së, **Riza Smaka**, tha se e mbështet në parim këtë projektligj. Ai pati vërejtje se titulli i projektligjit është tepër i gjatë, si dhe nenet 2.2 dhe 6 që dhe të përmirësohen gjatë shqyrtimit të dytë.

Në emër të Grupit parlamentar të AAK-së **Gjylnaze Syla**, tha se ky projektligj është i një rëndësie të veçantë për Kosovën, sepse hap dyert për investime infrastrukturore në Kosovë dhe investimin e kapitalit privat në pasurinë shtetërore. Por, ne kemi katër vërejtje kryesore në përmbajtjen e tij:

Vërejtja e parë, në këtë projektligj nuk duhet të trajtohet procedura për koncesion.

Vërejtja e dytë, format e partneritetit duhet të definohen më mirë në këtë projektligj.

Vërejtja e tretë, autoriteti publik kontraktues duhet të përcaktohet në ligj.

Vërejtja e katërt, ne kundërshtojmë formimin e Komisionit Drejtues Ndërministror. Me këto vërejtje këtë projektligj e mbështesim, në parim.

Në emër të Grupi Parlamentar të LDD-së **Berim Ramosaj**, tha se nxjerrja e këtij ligji është shumë e nevojshme, por vërejtja kryesore qëndron te dy komponentë. Edhe për krijimin e raporteve të mira të partnerizmit publiko-privat ishte dashur të nxirret një **ligj i veçantë për**

marrëdhëniet partneriste apo mundësinë e komunikimit partnerist midis pronës publike dhe pronës private dhe një **ligj i veçantë për koncesione**.

Ne mendojmë se hartimi i një ligji vetëm për koncesione do t'i zgjidhte shumë probleme të natyrës së tillë të hapësirave të mundshme investive për partnerët e huaj apo për partnerët tanë në fushat e caktuara, për të cilat Kosova nuk ka aftësi buxhetore t'i fuqizojë në sektorin e infrastrukturës, të shërbimeve të karakterit të gjerë. Ky kombinim midis koncesioneve, në njërën anë, dhe partneritetit publiko-privat, në anën tjetër, frikohem se do të humbë edhe rëndësinë e elementit koncesional, i cili është shumë i rëndësishëm për këtë fazë të zhvillimit të Kosovës.

Në emër të Grupi Parlamentar “7+”, **Xhezair Murati**, tha se e mbështesin në parim këtë projektligj, nxjerrja e të cilit është e domosdoshme për zhvillimin e vendit. Titulli i Projektligjit është i gjatë dhe duhet të jetë më konciz.

Në emër të Grupi Parlamentar SLS, **Bojan Stojanoviq**, tha se e mbështesin miratimin e këtij projektligji, në parim, dhe kontributin e tyre do ta japin gjatë shqyrtimit në komisionin funksional.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligji dhanë edhe këta deputetë: **Armend Zemaj, Edita Tahiri, Vladimir Todoroviq, Myzejene Selmanaj, Gani Koci dhe Ramadan Avdiu**, të cilat janë dhënë në transkript të kësaj seance.

Pastaj, **kryesuesi** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----76,
Kundër-----7,
Abstenime-----2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi në parim Projektligjin për partneritetet publiko-privat dhe koncesionet për sigurimin e infrastrukturës së shërbimeve publike dhe procedurat për dhënien e tyre.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa – si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian që ta shqyrtojnë këtë projektligj dhe Kuvendit t'ia paraqesin Raportin me rekomandime, për miratim.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për vula në institucionet e Republikës së Kosovës

Kryesuesi i informoi deputetët lidhur me procedurat e shqyrtimit të Projektligjit për vula në institucionet e Republikës së Kosovës, si dhe me raportet e komisioneve të përhershme parlamentare dhe të Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, si komision përgjegjës dhe raportues.

Ai ftoi kryetarin e komisionit raportues që ta arsyetojë Raportin dhe rekomandimet para deputetëve të Kuvendit.

Kryeari i Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, Esat Brajshori, prezantoi raportin e komisionit para deputetëve të Kuvendit dhe i ftoi që atë ta miratonin.

Deputetët nga radha e komuniteteve Mahir Yagcilar, Bojan Stojanovi, Enis Kervan dhe Numan Baliq kërkuan që të miratohet varianti nën b) i amendamentit 1, kurse deputetët Bahri Hyseni dhe Fehmi Mujata thanë se varianti nën a), i propozuar nga Komisioni Fubksional, është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Kryesuesi hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1 (a), 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 66;

Kundër----- 5.

Abstenime-----2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për vula në institucionet e Republikës së Kosovës.

Në vazhdim, seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit.

6. Shqyrtimi i Rekomandimit të Organit të pavarur për zgjedhës për emërimin e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit

Kryetari i njoftoi deputetët se Organi i Pavarur Përzgjedhës për përzgjedhjen e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit, në pajtim me Vendimin e Kuvendit, datë 16 maj 2008, ka shqyrtuar listën prej pesë kandidatëve, të propozuar nga Qeveria, për anëtarë të Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe Kuvendit ia ka rekomanduar listën për miratim me tre kandidatë për anëtarë të Organit Shqyrtues të Prokurimit, si në vijim:

1. Hysni Hoxha,
2. Tefik Sylejmani dhe
3. Demë Keka.

Ndërkohë, Qeveria i ka propozuar edhe dy kandidatë të tjerë për anëtarë të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Organi i Pavarur Përzgjedhës për përzgjedhjen e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit, më 23 korrik 2008, ka shqyrtuar kandidatët e propozuar nga Qeveria, për anëtarë të Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe Kuvendit ia ka rekomanduar, për miratim, listën më dy kandidatë për anëtarë të Organit Shqyrtues të Prokurimit, si në vijim:

1. Baki Krasniqi
2. Ekrem Salihu.

Raporti i Organit të Pavarur Përzgjedhës së bashku me propozimin e Qeverisë, u është shpërndarë deputetëve.

Pastaj, Kryetari hapi debatin lidhur me rekomandimin e Organit përzgjedhës.

Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së tha se mbështet rekomandimin e Organit përzgjedhës për emërimin e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Lutfi Haziri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së deklaroi se mbështet rekomandimet e Organit përzgjedhës për emërimin e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Ibrahim Makolli, në emër të Grupit parlamentar të AKR-së tha se nuk e mbështet rekomandimin e Organit përzgjedhës për emërimin e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së tha se nuk e mbështet rekomandimin e Organit përzgjedhës për emërimin e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Adem Salihaj, në emër të Grupi Parlamentar të LDD-së deklaroi se nuk e mbështet rekomandimin e Organit përzgjedhës për emërimin e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Sadik Idriz, në emër të Grupi Parlamentar “7+” tha se nuk do të marrin pjesë në votimin e këtij rekomandimi me arsyetimin se nuk është propozuar asnjë anëtarë nga radhët e komuniteteve.

Bojan Stojanoviq, në emër të Grupi Parlamentar SLS, tha se do të abstenojnë nga votimi për anëtarët e Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime në lidhje me rekomandimin e Organit përzgjedhës për emërimin e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit dhanë edhe këta deputetë: Melihate Tërmkolli, Riza Smaka, Armend Zemaj, Naim Maloku, Bahri Hyseni dhe Donika Kadaj-Bujupi, të cilat i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, Kryetari e hodhi në votim Rekomandimin e Organit përzgjedhës për emërimin e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----44,
Kundër-----35,
Abstenime-----1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, emëroi këta anëtarë të Organit Shqyrtues të Prokurimit:

1. Hysni Hoxha,
2. Tefik Sylejmani,
3. Demë Keka,
4. Baki Krasniqi dhe
5. Ekrem Salihu.

7. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2007

Kryetari i njoftoi deputetët se kryesuesi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, në pajtim me Ligjin për rregullatorin e energjisë, ka paraqitur Raportin vjetor të punës për vitin 2007.

Komisioni FunkSIONAL për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion, si komision funksional dhe e Komisioni për Buxhet e Financa e kanë shqyrtuar Raportin këtë raport dhe i kanë rekomanduar Kuvendit që ta miratojë.

Kryetari hapi debatin në lidhje me Raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2007.

Opinione, vërejte dhe sugjerime për Raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë dhanë: në emër të Komisionit Funkcional, **Myzejene Selmani**, në emër të Komisioni për Buxhet e Financa, **Gani Koci**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Haki Shatri**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Zylfi Merxha** dhe në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, **Bojan Stojanović**, si dhe deputetët: **Vezira Emrush**, **Ibrahim Makolli**, **Esat Makolli** dhe **Ramdan Avdiu**, të cilat janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e Raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----49,
Kundër-----17,
Abstenime-----7.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Raportin e Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2007.

8. Shqyrtimi i kërkesës së Qeverisë së Kosovës për tërheqjen e ligjeve nga procedura e shpalljes

Kryetari i njoftoi deputetët se Qeveria e Republikës së Kosovës ka kërkuar që dhjetë(10) ligjet e martuara, por të pa shpallura nga PSSP-ja, të tërhiqen nga procedura e shpalljes dhe të kthehen për ripunim në Qeveri, konform rrethanave të krijuara në Kosovë.

Kërkesa e Qeverisë, së bashku me listën e ligjeve të pashpallura, u është shpërndarë deputetëve.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e Qeverisë. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----74,
Kundër-----0,
Abstenime-----2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

- I.** Miratohet propozimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për tërheqjen e dhjetë (10) ligjeve të pashpallura për rihartim, sipas listës së specifikuar në shtojcë të këtij vendimi.

9. Shqyrtimi i kërkesës së grupeve parlamentare të Kuvendit për procedimin e ligjeve të pashpallura në rishqyrtim në komisionet parlamentare

Kryetari i njoftoi deputetët se gjashtë (6) grupe parlamentare kanë kërkuar që gjashtëmbëdhjetë (16) ligje të miratuara nga Kuvendi i Kosovës, por të pa shpallura nga PSSP-

ja, të tërhiqen nga procedura e shpalljes dhe të kthehen për rishqyrtim në komisione parlamentare, konform rrethanave të krijuara në Kosovë.

Kërkesa e grupeve parlamentare, së bashku me listën e ligjeve të pashpallura, u është shpërndarë deputetëve.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e grupeve parlamentare. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----76,
Kundër-----1,
Abstenime-----1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

I. Miratohet propozimi për procedimin e ligjeve të pashpallura për rishqyrtim në komisione parlamentare të Kuvendit.

II. Ngarkohen komisionet funksionale që t'i rishqyrtojnë ligjet e pa shpallura nga PSSP-ja dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime për këto projektligje:

1. Ligji nr. 2004/31 për të drejtat sendore,
2. Ligji nr. 2004/40 për avokatinë,
3. Ligji nr. 2004/43 për tubimet publike,
4. Ligji nr. 02/L-6 për lirinë e asocimit në OJQ,
5. Ligji nr. 02/L-73 për ndërprerjen e shtatzënësisë,
6. Ligji nr. 02/L-097 për shpronësimet me interes publik,
7. Ligji nr. 02/L-119 për letërnjoftimin,
8. Ligji nr. 02/L-125 për statusin civil,
9. Ligji nr. 02/L-135 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/11 për rrugët,
10. Ligji nr. 02/L-144 për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit,
11. Ligji nr. 03/L-002 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës,
12. Ligji nr. 03/L-003 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës,
13. Ligji nr. 03/L-004 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/9 për kooperativat e bujqve,
14. Ligji nr. 03/L-007 për procedurën jokontestimore,
15. Ligji nr. 03/L-018 për provimin përfundimtar dhe provimin e maturës shtetërore,
16. Ligji nr. 03/L-027 për taksën e akomodimit në objektet hoteliere turistike.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 16:00.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale